

Vë në dukje

Krimin



1. Cfarë është Crime Stoppers (programi për Ndalimin e Krimeve) dhe si funksionon?

Crime Stoppers është një bashkëpunim i përbashkët që përfshin Policinë e Viktorias dhe organizatat e komunitetit të cilët besojnë se publiku i përgjithshëm mund të ndihmojë në zgjidhjen e krimin. Ndihma e njerëzve mbetet anonim në shfaqjen e informacionit.

Disa krime të pazgjidhura janë publikuar nëpërmjet organeve të medias, me kërkesën që publiku të na ndihmojë. Njerëzit janë të inkurajuar që të tregojnë detajet e ndonjë sjellje kriminale.

2. Kur u krijua Crime Stoppers?

Crime Stoppers u krijua në Viktoria në vitin 1987 mbi bazën e sistemit të Neë Mexico, në SHBA. Ajo është e disponueshme për të gjithë popullin e Viktorias, që janë të interesuar për të ndihmuar në mbrojtjen e komunitetit.

3. Kur duhet të telefononi Crime Stoppers?

Në qoftë se krimi është duke ndodhur, do të jetë shumë më mirë që të telefononi numrin e urgjencës së Policisë së Viktorias (000) ose policinë lokale.

Në qoftë se informacioni juaj ka lidhje me një krim i cili ka ndodhur në të kaluarën, telefononi Crime Stoppers në numrin 1800 333 000. Ky numër duhet të përdoret për të raportuar informacionin. Në qoftë se ju keni dëgjuar se një krim po planifikohet të zhvillohet ose të raportoni një adresë ku është dukë u prodhuar ose shitur droga.

Në qoftë se keni nevojë për ndihmën e përkthyesit, telefononi zyrën e Interpretimit dhe Përkthimit në numrin 131 450 dhe i kërkonit që t'ju lidhin me Crime Stoppers të Viktorias.

4. Si funksionon centrali telefonik i Crime Stoppers?

Centralistë të trajnuar marrin telefonatat dhe mbajnë shënim detajet e dhëna. Informacioni dërgohet tek

departamenti i posacëm i Policisë së Viktorias për të marrë veprimet dhe investigimet e duhura. Detajet janë të rëndësishme. Identiteti i personit që bën telefonatën nuk është i nevojshëm dhe s'ka nevojë që të jepet. Anonimi i personit që bën telefonatën është pika kyçe e këtij sistemi.

5. A mund të gjendet ose të ndiqet telefonata?

Jo. Paisjet telefonike nuk tregojnë numrin e personit që bën telefonatën dhe Crime Stoppers nuk i regjistron telefonatat. Anonimi i personit që bën telefonatën është i sigurtë.



6. A është e mundur që ta dini nëse kjo telefonatë ju ka ndihmuar?

Telefonuesit mund t'ju jepet një numër kod për telefonatën e parë. Telefonuesit mund të bëjnë telefonatën e dytë tek numri 1800 333 000 katër ose pesë javë më vonë, duke treguar kodin e numrit të dhënë më parë. Crime Stoppers natyrisht që nuk kthejnë telefonatat tek personat anonim.

Vë në dukje Krimin

7. Cilat janë përfitimet?

Kënaqësia personale i Raportimeve nga telefonuesit për të ndihmuar në mbrojtjen e komunitetit të tyre duke kontribuar për ligjin dhe rendin dhe sigurinë e publikut. Dënimi pauses, dhe nganjëherë burgimi, i heq kriminelët nga qarkulimi. Një komunitet i cili është aktiv në mbrojtjen e vetvetes mundet gjithashtu të parandalojë ato njerëz që mund të shkelin ligjin. Kursimi i vendburimeve të policisë, duke përfshirë kohën e cmuar që kanë shpenzuar në investigime, nuk mund të llogaritet, por është një përfitim i jashtëzakonshëm për të gjithë ne.

8. A ka ndonjë përfitim tjetër?

Në qoftë se ndodh ndonjë arrestim nga informacioni i dhënë, policia mund të rekomandojë tek Komisioni i Crime Stoppers të Viktorias që telefonuesi të marrë një shpërblim deri në 1000, varet sesa serioz është krimi. Kjo mund të paguhet në mënyrë anonime në qoftë se telefonuesi mirëmban dhe tregon numrin e kodit të telefonatës.

9. A është Crime Stoppers i suksesshëm?

Qysh prej vitit 1987, kjo qëndër ka marrë më shumë se 452 000 telefonata, të cilat kanë çuar në 7 500 arrestime dhe më shumë se 32 800 gjoba. Është kapur drogë me vlerën më shumë se 76 milion dollarë dhe mallra dhe janë zbuluar mallara ose sende të vjedhura me vlerën më shumë se 22 milion dollarë.

10. A nuk është fshehja e një veprimi jo-Australiane?

Jo të gjitha traditat janë të ndjeshme. Është një gjë që ti diskurajoni fëmijët “që të mos gënjejnë” në kopshtin e lojrave. Por është një gjë krejt tjetër të mbashë informacione të rëndësishme rreth krimit kur siguria e komunitetit është në rrezik. Në qoftë se jeta e njerëzve dhe pronat janë kërcënuar nga një kriminel që ka mbetur i pazbuluar, nuk ka gjë më të keqe se ta fshehësh atë. Dhënia e informacionit është një veprim i përgjegjshëm nga një kontribues i vlefshëm për një komunitet që të jetojë i sigurtë. Mosraportimi i informacionit rreth krimit nuk është Australiane.



www.vic.crimestoppers.com.au

“Crime Stoppers është rreth rregullores së bashkëpunimit me ndihmën e komunitetit, medias dhe policisë, të gjithë të punojmë sëbashku për të ndihmuar në zgjidhjen e krimeve në të gjithë shtetin.

Për mëse 15 vjet Crime Stoppers kanë ndihmuar Policinë e Viktorias për të kapur kriminelët.

Një nga përfitimet më të mëdha të Crime Stoppers është se njerëzit mund të sigurojnë informacione dhe mbeten totalisht anonim.”

Christine Nixon
Shefja e Policisë së Viktorias

Printuar me ndihmën e Fondit

Ndihmës të Komunitetit të Qeverisë
së Viktorias dhe Motorola.

